



ALBANIAN GREEN ENERGY sh.p.k
Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
Së bashku me Raportin e Audituesit të Pavarur

PËRMBAJTJA:

	FAQE
RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR	1
PASQYRAT FINANCIARE:	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	3
PASQYRA E PERFORMANCËS	4
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	5
PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE	6
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE	7 - 22

RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për Menaxhimin dhe ortakun e Shoqërisë "Albanian Green Energy" sh.p.k

Opinion me Rezervë

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Shoqërisë "Albanian Green Energy" sh.p.k (Shoqëria), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datën 31 Dhjetor 2019, pasqyrën e performancës, pasqyrën e fluksit të mjeteve monetare dhe pasqyrën e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur në këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më datën 31 Dhjetor 2019, performancën e saj financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara në Shqipëri.

Baza për Opinion me Rezervë

Siç parashikohet në standardin kontabel të kontabilitetit numër 13 Aktivet biologjike dhe marrëveshjet koncesionare në fuqi nga viti 2014, marrëveshja e koncesionit duhet të ishte trajtuar si një aktiv afatgjatë jomaterial dhe të amortizohej në mënyrë lineare në përpudhje me jetëgjatësinë e marrëveshjes. Për pasojë, paraqitja e investimit në hidrocentrale si Aktive Afatgjatë Material të klasifikuara në zërat e ndërtesës dhe makineri e pasisjeve, nuk është në përputhje me kërkesat e SKK 13. Bazuar në informacionin që kemi, ne nuk jemi në gjendje të përlllogarisim efektet që trajtimi i marrëveshjes së koncesionit sipas kërkesave të SKK 13 në vend të SKK 5 do të kishte në amortizimin e vitit, amortizimin e akumuluar dhe rezultatet e mbartura.

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Theksim çështje

Ne tërheqim vëmendjen për shënimin 2.5.3 të pasqyrave financiare, i cili përshkruan vlerësimin e menaxhimit në lidhje me ndikimin aktual dhe potencial të pandemisë së COVID - 19 dhe për arsyen e aplikimit të parimit të vijueshmërisë për përgatitjen e pasqyrave financiare. Opinioni ynë nuk është modifikuar në lidhje me këtë çështje.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Shoqërisë për të vazhduar aktivitetin e saj në bazë të parimit të vijueshmërisë, shënimet shpjeguese, si edhe për çështjet që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të shoqërisë, duke përdorur parimet bazë të vazhdimësisë, përveç rastit kur drejtimi ka për qëllim të likujdojë aktivitetin, ose të ndërpresë aktivitetin operacional, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale përveçse më lart.

Palët e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.


Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomalitë materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomalitë materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë periudhës së auditimit. Gjithashtu ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, planifikojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse për zbutjen e këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidencë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e mashtrimit është më i lartë se rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptueshmëri të atyre kontrolleve të brendshme relevante për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit në përputhje me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël të kryera si edhe paraqitjen në shënime shpjeguese përkatëse të bëra nga Drejtimi.
- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijimësisë, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, mbi ekzistencën e një pasigurie materiale mbi aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi aktivitetin e saj. Nëse një pasiguri materiale ekziston, ne duhet të tërheqim vëmendjen në shënimin shpjegues përkatës, nëpërmjet raportit tonë të auditimit, ose nëse shënime shpjeguese nuk janë të përshtatshme ne duhet të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona jepen mbi bazën e evidencës së auditimit të marrë deri më datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë ndërprerje të aftësisë së Shoqërisë për vijimësi.
- Vlerësojmë paraqitjen, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare dhe të shënimeve shpjeguese dhe në rast se ato përfaqësojnë drejt transaksionet dhe ngjarjet.

Ne komunikojmë me personat të ngarkuar për qeverisjen e Shoqërisë, përveçse çështjeve të tjera, edhe objektin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi relevante në kontrollin e brendshëm të identifikuar gjatë auditimit tonë.



Diana Ylli (Golemi)
Auditues Ligjor

 MAZARS
Pr. Emin Duraku, Pall. "Binjaket",
No.5, 1000, Tirana, Albania
phone : +355 42 27 80 15
www.mazars.al . info@mazars.al

07 Maj 2020

Pasqyra e Pozicionit Financiar
më 31 dhjetor 2019

	Shënime	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
AKTIVE			
Aktive afatshkurtra			
Mjete monetare	4	36,791,331	67,546,629
Llogari të arkëtueshme tregtare	5	37,317,714	31,557,691
Të tjera llogari të arkëtueshme	6	4,835,009	956,015
Inventarë	7	56,640	56,960
Parapagime dhe shpenzime të shtyra	8	1,594,574	1,964,511
Totali i aktiveve afatshkurtra		80,595,268	102,081,806
Aktivët afatgjatë			
Aktive afatgjatë materiale	9	190,891,518	195,443,599
Aktive afatgjatë jomateriale	9	-	136,500
Totali i aktiveve afatshkurtra		190,891,518	195,580,099
Totali i aktiveve		271,486,786	297,661,905
DETYRIMET			
Detyrime afatshkurtra			
Llogari të pagueshme tregtare	10	8,750,126	2,374,522
Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura	11	23,425,607	28,323,676
Detyrime tatimore	12	6,183,225	9,543,610
Të tjera detyrime	13	20,472,751	14,686,536
Totali i detyrimeve afatshkurtra		58,831,709	54,928,344
Detyrime afatgjatë			
Llogari të pagueshme nga palët e lidhura		-	-
Totali i detyrimeve afatgjatë		-	-
Totali i detyrimeve		58,831,709	54,928,344
Kapitali			
Kapitali i nënshkruar		100,000,000	100,000,000
Rezerva ligjore		10,249,911	10,249,911
Rezerva të tjera		70,483,650	65,911,568
Fitimi i ushtrimit		31,921,516	66,572,082
Totali i kapitalit	14	212,655,077	242,733,561
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		271,486,786	297,661,905

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 22, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyra e Performancës
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

		Për vitin e mbyllur Shënime më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	15	244,373,807	317,531,493
Puna e kryer nga njësia ekonomike e kapitalizuar	16	-	613,240
Të ardhura të tjera të shfrytëzimit	17	(107,697)	2,639,609
Total të ardhura		244,266,110	320,784,342
Lënda e parë, materiale të konsumueshme dhe të tjera shpenzime		(140,224,355)	(172,126,655)
1) Lënda e parë, materiale të konsumueshme	18	(126,040,778)	(155,775,165)
2) Të tjera shpenzime	19	(14,183,577)	(16,351,490)
Shpenzime të personelit	20	(45,579,206)	(49,091,566)
1) Paga dhe shpërblime		(41,013,913)	(44,354,358)
Shpenzime të sigurimeve			
2) shoqërore/shëndetësore		(4,565,293)	(4,737,208)
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	9	(18,943,662)	(19,742,715)
Provizione dhe zhvleresime	21	(1,144,331)	(1,000,000)
Shpenzime të tjera të shfrytëzimit	22	(104)	(2,331)
Shpenzime financiare		(158,108)	128,595
1) Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme	23	(156,837)	128,595
2) Shpenzime të tjera financiare	24	(1,271)	-
Fitimi/humbja para tatimit		38,216,344	78,949,670
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin		(6,294,828)	(12,377,588)
1) Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin	25	(6,294,828)	(12,377,588)
Fitimi/humbja e vitit		31,921,516	66,572,082
Totali i të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse për vitin		-	-
Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin		31,921,516	66,572,082

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 22, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Albanian Green Energy sh.p.k

(Vlerat janë në Lek)


Pasqyra e ndryshimeve në Kapital
Për vitin e mbylltur më 31 dhjetor 2019

	Kapitali i nënshkruar	Rezerva Statutore dhe Ligjore	Rezerva të tjera	Fitim / Humbja e vitit	Totali
Pozicioni financiar më 1 Janar 2018	100,000,000	10,249,911	60,092,020	5,819,548	176,161,479
Fitim/humbja e vitit				66,572,082	66,572,082
Transferim i fitimit të vitit në rezerva			5,819,548	(5,819,548)	-
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2018	100,000,000	10,249,911	65,911,568	66,572,082	242,733,561
Fitim/humbja e vitit				31,921,516	31,921,516
Transferim i fitimit të vitit në rezerva			66,572,082	(66,572,082)	-
Dividendë të paguar			(62,000,000)		(62,000,000)
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2019	100,000,000	10,249,911	70,483,650	31,921,516	212,655,077

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 22, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin e mbylltur më 31 dhjetor 2019 janë aprovuar nga administratori i Albanian Green Energy sh.p.k më 30/06/2020 dhe janë firmosur si më poshtë.


ALBANIAN GREEN ENERGY Sh.p.k.
 Administrator
 Rr.A. Topiani, Torre Drin, Ap.61
 TIRANE


 Neshtamije Boshaj

Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Flukset e parasë nga aktivitetet operative		
Fitim / Humbja e vitit	31,921,516	66,572,082
Rregullimet për shpenzimet jomonetare:		
Shpenzimet financiare jomonetare	173,804	280,404
Shpenzimet për tatimin mbi fitimin jomonetar		(3,808,081)
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	18,943,662	19,742,715
Fluksi i mjeteve monetare i përfshirë në aktivitetet investuese:		
Rënie/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera	(9,639,017)	35,144,871
Rënie/(rritje) në inventarë	320	11,499,480
Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme	10,210,109	32,784,012
Rënie/(rritje) në parapagime dhe shpenzime të shtyra	369,937	(718,744)
Tatim mbi fitimin e paguar	(6,294,828)	(8,569,507)
Rritje/(rënie) në detyrime për punonjësit	(11,916)	(509,224)
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit	45,673,587	152,418,008
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit		
Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale	(14,255,081)	(18,331,332)
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit	(14,255,081)	(18,331,332)
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit		
Pagesa e huave	-	(69,577,882)
Interes i paguar	(156,837)	(74,159)
Dividendë të paguar	(62,000,000)	-
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit	(62,156,837)	(69,652,041)
Ndryshimi neto i mjeteve monetare	(30,738,331)	64,434,635
Mjetet monetare në fillim të periudhës	67,546,629	5,352,868
Efekti i luhatjeve të kursit të këmimit	(16,967)	(2,240,874)
Mjetet monetare në fund të periudhës	4 36,791,331	67,546,629

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 22, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

1. Informacion i përgjithshëm

Shoqëria Albanian Green Energy Shpk është krijuar më 21/12/2006.

Veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitave përkatëse të ligjit Nr. 9901 datë 14/04/2008, "Për Shoqëritë tregtare" dhe nga statuti i saj.

Shoqëria Albanian Green Energy Shpk është shoqëri shqiptare me ortak Essegei SpA shoqëri e së drejtës italiane që zotëron 100% të kuotave të kapitalit të shoqërisë.

Kapitali i shoqërisë është 100.000.000 Lek. Administrator i shoqërisë është Z. Eugenio Rossato.

Selia e shoqërisë ndodhet në Njësinë Bashkiake Nr.2, Rruga "Abdi Toptani", Torre Drin, Ap.61. Tiranë. Shoqëria është regjistruar në organet tatimore të rrethit Tiranë me NIPT K71624027U.

Aktiviteti kryesor i kësaj shoqërie është prodhimi i energjisë elektrike.

Numri mesatar i punonjesve gjate vitit 2019 është 35 punonjës (2018: 38)

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe ligjin nr.25/2018 datë 30 maj 2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

Në bazë të urdhrin nr. 64 datë 22.7.2014 "Për shpalljen e standardeve kombëtare të kontabilitetit të përmirësuara dhe zbatimin e detyrueshëm të tyre", Ministria e financave vendosi të bëjë të detyrueshme zbatimin e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara duke filluar nga 1 janar 2015.

Ky urdhër hyri në fuqi me fletoren zyrtare nr.119, datë 1 gusht 2014.

2.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.5. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare (vazhdim)

2.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga pa mundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

2.5.2. Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50% , në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

2.5.3. Gjykime mbi efektet pandemise ne parimin e vijimesise

Ndërsa situata pandemike COVID-19 ende po evoluon në Shqipëri dhe në mbarë botën, ka pasiguri të lartë mbi shtrirjen e saj në kohën e lëshimit të këtyre pasqyrave financiare. Si pasojë, menaxhimi nuk është në gjendje të vlerësojë me siguri dhe të sigurojë një vlerësim sasior të ndikimit të mundshëm të kësaj pandemie në kompani. Ndërsa masat kufizuese vazhdojnë, volumi i shitjeve, fluksi i parasë, zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme, inventari dhe fitimi mund të ndikohen. Sidoqoftë, në datën e këtyre pasqyrave financiare, kompania po operon, vazhdon të përmbushë detyrimet e saj në kohën e duhur dhe për këtë arsye vazhdon të zbatojë parimin e vijimësisë në përgatitjen e pasqyrave financiare.

2.6. Krahasueshmëria e informacionit kontabël

Siç paraqitet në Standardin Kombëtar të Kontabilitet të përmirësuar nr.1, në rastet e një ndryshimi në paraqitjen e pasqyrave financiare si pasojë e kërkesave të një standardi të ri, një përmirësimi në standard apo një ndryshimi në ligjin për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, informacioni krahasues duhet të riparaqitet për të korresponduar me paraqitjen e re, përvec rasteve kur riparaqitja e informacionit krahasues nuk mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme.

3. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	2019	2018
Euro/LEK	121.77	123.42
USD/LEK	108.64	107.82

3.2. Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivitet financiarë regjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare regjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuara duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

(Vlerat janë në Lek)

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.2. Instrumentat financiare (vazhdim)

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar njihet me vlerën nominale.

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivitetet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivitetet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerrtet nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivitetet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.3. Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

FW

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.4. Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe koston e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivit.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2019 dhe 2018 është si më poshtë:

Kategoria e AAM-ve	Norma e Amortizimit në %
Ndërtimore	5
Makineri e Pajisje	20
Mjete transporti	20
Pajisje zyre	20
Pajisje kompjuterike	25
Të tjera	20

iv. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit.

Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

3.4. Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësi ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.5. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

3.6. Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

Shoqëria ka vetëm qira operative.

3.7. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3.8. Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i prituri për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2019 është 15% (2018: 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlllogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Gjendjet e shtyra tatimore maten me normat tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat pritet të zbatohen për periudhën kur diferencat e përkohshme do të anulohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet.

Aktivitet tatimore të shtyra për diferencat e përkohshme të zbritshme regjistrohen deri në atë masë që është e mundur që fitimi i tatueshëm në të ardhmen të mund të përdoret për zbritjet në fjalë.

(Vlerat janë në Lek)

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.9. Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributesh pensioni të përcaktuar.

3.10. Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

3.11. Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

3.12. Aktivet dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

4. Mjete monetare

Mjetet monetare në arkë dhe bankë detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Mjete monetare në bankë	36,217,260	67,541,235
Llogari rrjedhëse	36,217,260	67,541,235
Mjete monetare në arkë	574,071	5,394
	<u>36,791,331</u>	<u>67,546,629</u>

5. Llogari të arkëtueshme tregtare

Llogaritë e arkëtueshme tregtare më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
OSHEE për fatura në proces çertifikimi	37,317,714	31,557,691
	<u>37,317,714</u>	<u>31,557,691</u>

(Vlerat janë në Lek)

6. Të tjera llogari të arkëtueshme

Llogaritë e tjera të arkëtueshme më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Paradhenie per personelin	663,948	7,341
Tatimi mbi fitimin i mbingarkuar	3,422,191	-
Detyrim doganor i mbingarkuar	8,406	8,210
Garanci te ndryshme	240,464	240,464
Tarife aplikimi ERE per licences e re	500,000	700,000
Pagesat e kryera në lidhje me çështjen gjyqësore me Sigal UGA	995,387	995,387
Zhvlerësim i pagesave të kryera në lidhje me çështjen gjyqësore me Sigal UGA	(995,387)	(995,387)
Takse gjyqësore 1% per ceshtjen ndaj OSHEE	672,102	527,771
Provigjon i krijuar per shpenzimet gjyqësore 1%	(672,102)	(527,771)
Taksa Bashkia Selenice	2,600,000	1,600,000
Provizion i krijuar per ceshtjen e taksave lokale Bashkia Selenice	(2,600,000)	(1,600,000)
	<u>4,835,009</u>	<u>956,015</u>

7. Inventarë

Inventari më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqitet si me poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Lendë djegëse	56,640	56,960
	<u>56,640</u>	<u>56,960</u>

8. Shpenzime të shtyra

Shpenzimet e shtyra detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Shpenzime të shtyra Prime sigurimesh	1,594,574	1,901,018
Parapagime per blerje	-	63,493
	<u>1,594,574</u>	<u>1,964,511</u>

Albanian Green Energy sh.p.k
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbylltur më 31 dhjetor 2019
(Vlerat janë në Lek)

9. Aktive afatgjata material

Kosto	Makineri dhe			Të tjera	Asete në proçes	Totali	AAJM
	Ndërtesa	Pajisje	Mjete transporti				
Gjendja më 1 Janar 2018	187,441,299	285,615,989	2,571,295	4,285,369	-	479,913,952	1,755,700
Shtesa	920,157	14,419,049	963,254	1,412,072	616,800	18,331,332	
Pakësime							
Gjendja më 31 dhjetor 2018	188,361,456	300,035,038	3,534,549	5,697,441	616,800	498,245,284	1,755,700
Shtesa	5,360,798	6,818,385	746,340	668,808	660,750	14,255,081	
Transferime	1,277,550				(1,277,550)		
Pakësime							
Gjendja më 31 dhjetor 2019	194,999,804	306,853,423	4,280,889	6,366,249	-	512,500,365	1,755,700
Amortizimi i akumuluar							
Gjendja më 1 Janar 2018	41,298,026	236,390,476	2,047,875	3,556,593	-	283,292,970	1,385,200
Amortizimi i vitit	7,314,224	11,339,854	249,172	605,465.00		19,508,715	234,000
Pakësime							
Gjendja më 31 dhjetor 2018	48,612,250	247,730,330	2,297,047	4,162,058	-	302,801,685	1,619,200
Amortizimi i vitit	7,084,998	10,877,008	347,012	498,144	-	18,807,162	136,500
Pakësime							
Gjendja më 31 dhjetor 2019	55,697,248	258,607,338	2,644,059	4,660,202	-	321,608,847	1,755,700
Vlera neto kontabël							
Gjendja më 31 dhjetor 2018	139,749,206	52,304,708	1,237,502	1,535,383	616,800	195,443,599	136,500
Gjendja më 31 dhjetor 2019	139,302,556	48,246,085	1,636,830	1,706,047	-	190,891,518	-

Tur

10. Llogari të pagueshme tregtare

Llogaritë e pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Llogari ndaj furnitorëve për fatura të pranuar	8,175,995	2,204,356
Llogari ndaj furnitorëve për fatura të pamberritura	574,131	170,166
	<u>8,750,126</u>	<u>2,374,522</u>

11. Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura (afatshkurtëra)

Llogaritë e pagueshme ndaj palëve të lidhura më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Llogari të pagueshme tregtare ndaj palëve të lidhura	22,180,607	28,323,676
Ortake-Dividenti	1,245,000	-
	<u>23,425,607</u>	<u>28,323,676</u>

12. Detyrime tatimore

Detyrimet tatimore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Detyrimi për Sigurimet Shoqërore dhe Shëndetësore	646,575	663,308
Detyrimi për Tatimin mbi të Ardhurat Personale	624,752	765,493
Detyrimi për Tatimin në burim	1,792,591	1,595,230
Detyrimi për TVSH-ne	3,119,307	2,711,498
Detyrime për tatim fitimin	-	3,808,081
	<u>6,183,225</u>	<u>9,543,610</u>

13. Të tjera detyrime

Detyrimet e tjera për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Detyrime për Pagën Neto	3,182,220	3,194,136
Detyrime për Taksën e Shfrytëzimit të ujit dhe të tjera	16,803,928	11,183,330
Detyrime për Tarifen rregullatore të E.R.E.-s	486,603	309,070
	<u>20,472,751</u>	<u>14,686,536</u>

(Vlerat janë në Lek)

14. Kapitali

Kapitali i shoqërisë është 100.000.000 LEK i zotëruar 100% nga ortaku ESSEGEI S.p.A shoqëri e së drejtës italiane më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqitet si më poshtë:

	31 dhjetor 2019				31 dhjetor 2018			
	Kuota	Vlera nominale	Kapitali i nënshkruar	%	Kuota	Vlera nominale	Kapitali i nënshkruar	%
ESSEGE spa	100,000	1,000	100,000,000	100%	100,000	1,000	100,000,000	100%
	100,000		100,000,000	100%	100,000		100,000,000	100%

Shoqëria ka fitim më 31 dhjetor 2019 në vlerën 31,921,516 LEK (2018: 66,572,082 LEK).

15. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Të ardhura nga shitja e energjise elektrike	244,373,807	317,531,493
	244,373,807	317,531,493

Rakordimi i të ardhurave me deklaratat e TVSH-së.

	31 dhjetor 2019
Rakordimi i të ardhurave me FDP-në	
Qarkullim i tatueshëm	244,722,693
Faturuar rimbursim shpenzimesh pasqyruar ne zbritje te shpenzimeve	(348,886)
Shuma e qarkullimit e korrektuar	244,373,807
Te ardhura nga diferencat e kursit përfshirë per neto në zërin "Të ardhura të tjera të shfrytëzimit"	118,317
Te ardhura nga diferencat e kursit përfshirë në zërin "Shpenzime financiare"	-
Te ardhura nga interesat përfshirë në zërin "Shpenzime financiare"	1,896
Te ardhura total sipas Kontabilitetit	244,494,020
Te ardhura total deklaruar ne FDP	244,494,020
Diferenca	-

16. Puna e kryer nga njësia ekonomike e kapitalizuar

Puna e kryer nga njësia ekonomike e kapitalizuar detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>
Puna e kryer nga njësia ekonomike e kapitalizuar	-	613,240
	<u>-</u>	<u>613,240</u>

17. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit përfshijnë fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit nga aktiviteti tregtar dhe detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>
Fitim nga këmbimet valutore	118,317	4,909,784
Humbje nga këmbimet valutore	(226,014)	(2,270,175)
	<u>(107,697)</u>	<u>2,639,609</u>

18. Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme dhe shërbime

Në këtë zë paraqiten kostoja e mallrave, lëndeve të para dhe shërbimeve të konsumuara që lidhen me veprimtarinë e shfrytëzimit. Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>
Blerje materiale te para ndërtimore dhe elektromekanike	10,960,746	17,788,175
Lende djegese dhe vaj lubrifikant	3,570,033	3,752,023
Inventar i imet	656,691	980,084
Konsumi ujit dhe energjise elektrike	755,087	897,571
Qera mjete transporti	-	658,824
Mirembajtje dhe riparime	28,927,928	36,238,271
Prime te sigurimit për hidrocentralin	4,464,916	4,980,992
Prime te sigurimit për personelin dhe pergjegjesine ne pune	1,238,874	940,585
Konsulence teknike dhe manaxheriale	29,562,200	30,733,406
Kontrolli i njohurive teknike	30,000	45,000
Royalties	39,099,808	50,805,040
Shpenzime udhetimi e dieta	232,000	142,900
Shpenzime per licencen ERE	200,000	200,000
Tarife ERE	486,603	309,070
Taksa e shfrytëzimit te ujit	5,620,598	7,303,224
Tarife per te drejte perdorimi toke	235,294	-
	<u>126,040,778</u>	<u>155,775,165</u>

19. Të tjera shpenzime

Shpenzimet e tjera detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Shpenzime kancelarie e materiale pastrimi	360,826	254,625
Qira për zyra dhe printeri	2,244,939	2,285,570
Mirëmbajtje për zyrat - pajisjet informatike	36,180	345,272
Mirëmbajtje riparime automjetet	1,397,940	1,784,800
Prime të sigurimit automjetet	96,398	96,363
Konsulence ekonomike, juridike	2,870,417	3,785,600
Kuota anëtaresimi, pjesëmarrje në panair e abonime	301,533	701,203
Shpenzime për ambientet e perbashkëta e te tjera	272,791	245,025
Shpenzime udhëtimi/dieta	1,246,934	1,314,057
Shpenzime telefoni dhe interneti	582,921	583,564
Shpenzime bankare	342,323	354,644
Taksa vendore e të tjera	875,686	631,763
Shpenzime për sponsorizime	123,380	129,340
Shpenzime për pritje	856,474	1,352,540
Shpenzime restoranti	1,178,713	1,121,615
Shpenzime transporti	-	331,576
Shpenzime administrative noteraiale	188,700	-
Shpenzime të tjera	1,207,422	1,033,933
	14,183,577	16,351,490

Sherbimet e dhenies se sigurise dhe auditim nga shoqeria Mazars per vitin 2019 eshte ne vlere 944,025Lek.

20. Shpenzime të personelit

Shpenzimet e personelit detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Shpenzime për paga dhe shperblime	40,983,913	44,017,858
shperblim per punonjesit per raste fatkeqesie	30,000	336,500
Shpenzime për sigurime shoqërore e shëndetësore	4,565,293	4,737,208
	45,579,206	49,091,566

Numri mesatar i punonjesve gjate vitit 2019 eshte 35 punonjes (2018 : 38)

Struktura e stafit eshte paraqitur si me poshte :

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
Administrator	1
Staf tjetër Administrate	10
Inxhinier	2
Staf tjetër Operacional	22
	35

(Vlerat janë në Lek)

21. Provizione dhe zhvlerësime

Provizionet dhe zhvlerësimet detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>
Provizion i krijuar për taksat lokale	1,000,000	1,000,000
Provizion i krijuar për taksat gjyqesore	144,331	-
	<u>1,144,331</u>	<u>1,000,000</u>

22. Shpenzime të tjera të shfrytëzimit

Shpenzimet e tjera të shfrytëzimit paraqesin gjobat dhe penalitetet për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>
Gjopa dhe penalitete	104	2,331
	<u>104</u>	<u>2,331</u>

23. Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme

Shpenzimet interesi dhe shpenzime të ngjashme përfshijnë shpenzimet dhe te ardhurat e interesit. Ky zë detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>
Te ardhura nga interesi dhe kamat vonesat ngjashme	1,896	(1,821,125)
Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme	(158,733)	1,692,530
	<u>(156,837)</u>	<u>(128,595)</u>

24. Shpenzime të tjera financiare

Shpenzimet te tjera financiare përfshijnë shpenzimet dhe te ardhurat nga kursi i këmbimit që lidhet me aktivitetin financiar të shoqërise. Ky zë detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>
Fitim nga këmbimet valutore	-	-
Humbje nga këmbimet valutore	(1,271)	-
	<u>(1,271)</u>	<u>-</u>

Albanian Green Energy sh.p.k
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(Vlerat janë në Lek)

25. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

Përlllogaritja e shpenzimit për tatimin mbi fitimin paraqitet më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
<i>Fitimi para tatimit</i>	38,216,344	78,949,670
Total shpenzime të panjohura	3,749,174	3,567,585
Shpenzime per pritje percjellje	123,353	398,106
Penalite, gjoba e dëmshpërblime	104	2,331
Shpenzime zhvleresimi(provizioni)	1,144,331	1,000,000
Shpenzime te tjera pa fature te rregullt tatimore	2,481,386	2,167,149
<i>Fitimi para tatimit (përfshirë shpenzimet e panjohura)</i>	41,965,518	82,517,255
<i>Tatim fitimi @15%</i>	6,294,828	12,377,588
	31,921,516	66,572,082

26. Transaksionet me palët e lidhura

Balancat me palët e lidhura më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2019		31 dhjetor 2018	
	Të arkëtueshme	Të pagueshme	Të arkëtueshme	Të pagueshme
Essegei Spa	-	12,435,663	-	12,829,629
Idro Power Service	-	10,989,944	-	15,494,047
	-	23,425,607	-	28,323,676

Detajet e transaksioneve me palët e lidhura gjatë vitit të mbyllur me 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2019		31 dhjetor 2018	
	Shitje	Blerje	Shitje	Blerje
Essegei Spa	-	53,882,307	-	67,690,511
Hydra Energia	-	407,648	-	416,800
Balkan Green Energy	348,884	-	350,751	7,478
Idro Power Service	-	44,828,187	-	59,333,273
	348,884	99,118,142	350,751	127,448,062

Shpërblimi total i dhënë stafit drejtues për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 është 413,196 LEK (2018: 413,196 LEK).

(Vlerat janë në Lek)

27. Ngjarje pas bilancit

Më 11 Mars 2020, Organizata Botërore e Shëndetit e deklaroi koronavirusin (COVID-19) një pandemi. Ndërsa situata është ende duke u zhvilluar në Shqipëri dhe në mbarë botën, ka pasiguri të lartë mbi shtrirjen e saj në kohën e lëshimit të këtyre pasqyrave financiare. Menaxhimi pret që zhvlerësimi i llogarive të arketueshme, inventari të ndikohen nga situata. Impakti financiar do të njihet nga Kompania gjatë vitit 2020. Menaxhimi do të vazhdojë të monitorojë ndikimin e mundshëm dhe do të ndërmarrë të gjitha hapat e mundshëm për të lehtësuar çdo efekt. Menaxhimi e konsideron këtë pandemi si një ngjarje që nuk rregullohet pas datës së raportimit dhe e ka shpalosur në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare. Efektet mbi bazën e vijimësisë në përgatitjen e pasqyrave financiare janë shpalosur në shënimin 2.5.3 të këtyre pasqyrave financiare.

Nuk ka asnje ngjarje pas dates se bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime ne keto pasqyra financiare.